

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DHE BASHKIMI EUROPIAN.¹

nga Bedri Çoku

Në këto ditë që po flitet kaq shumë për audit dhe auditim, Bashkimi Evropian, nëpërmjet Raportit të Progresit që përgatit çdo vit Komisioni Evropian (qeveria e BE-së), i tregoi shoqërisë shqiptare vlerat e institucionit më të lartë publik të auditimit. Ky institucion është Kontrolli i Lartë i Shtetit. Gjatë këtyre 10 viteve të fundit, BE ka prodhuar çdo vit një raport progresi për Shqipërinë dhe asnjëherë, në kapitullin e përmbushjes së kriterit politik, nuk ka përfshirë KLSH në këtë Raport. Këtë vit e bëri. Sipas Progres - Raportit 2013 të Komisionit Evropian për Shqipërinë (faqe 8, kapitulli për Kriterin Politik), BE thotë se “Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka përmirësuar performancën e tij... KLSH ka dorëzuar në Prokurori 40 kallzime për hetime penale (që përfshijnë 125 punonjës), dy herë më shumë se gjatë tre viteve të kaluara së bashku, duke theksuar në veçanti abuzimin me pronën publike nga administratorët publikë të rangut të lartë”. Nuk e di nëse ka fraza më bindëse për cilindo shqiptar që është i interesuar për qeverisjen e mirë publike dhe luftën kundër korrupsionit, për të kuptuar vlerën e institucionit më të lartë të auditimit në Shqipëri. Gjatë dy viteve të fundit, vëmendja e KLSH është përqëndruar tërësisht në dy sfidat e tij madhore, në modernizimin dhe rritjen e kapaciteteve audituese, duke zbatuar me përgjegjësi standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, si dhe në përmirësimin e qeverisjes publike, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit. Krahas përgatitjes së bazës së re ligjore të aktivitetit të tij, KLSH në periudhën janar 2012- shtator 2013 ia doli të ndërtojë kapacitete bashkëkohore të auditimit, me trajnime të njëpasnjëshme dhe të përqendruara në standardet ISSAI, në auditimin e

performancës, auditimin financiar, auditimin e perputhshmërisë dhe në atë të teknologjisë së informacionit. Audituesit e tij morën njohuri më të thella dhe të gjëra për auditimin bashkëkohor të prokurimeve dhe kontratave publike. Institucioni përdori ekspertët më të mirë vendas si dhe ekspertët e huaj të institucioneve të tilla me emër të auditimit publik, si Zyra Kombëtare e Auditimit (NIK) e Polonisë, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë apo programe të Bashkimit European, si SIGMA... KLSH arriti të dërgojë të gjithë punonjësit e vet të paktën një herë jashtë shtetit për të marrë eksperiencë në institucionet simotra. Eksperienca në auditim është jetësore për një institucion që vjen nga tipi i vjetër i kontrollit si inspektim financiar. Duhet të kemi më shumë besim në kapacitetet dhe forcën e një institucioni të pavarur kushtetues, si KLSH. Ai mund të sjellë dhe po sjell vlerë të shtuar në qeverisjen publike, nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimet e tij. Mjafton të kujtojmë auditimin e tij të fundit, të publikuar dy ditë më parë, për Inspektoratin Shtetëror të Punës. E, nëse ky inspektorat merr ato masa që propozon KLSH dhe inspekton të gjitha kompanitë private që punësojnë mbi 10 punonjës, brenda një viti në Arkën e Shtetit shkojnë rreth 170 milionë euro, në formën e kontributeve deri tani të papaguara për punonjësit e sektorit privat, të parregjistruar si të tillë në regjistrin e Inspektoratit, pasi deri tani askush nga inspektorët nuk kishte vënë ujët në zjarr për t'i kontrolluar. KLSH ka qenë i pari në tetor 2012, që i ka propozuar Kuvendit, nëpërmjet auditimit të tij për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2011, që të vendoset në Kushtetutë pragu i Borxhit Publik të vendit prej 60 përqind të GDP-së. Ka qenë gjithashtu ky institucion që në këtë kohë ka paralajmëruar për borxhin e madh të qeverisë ndaj biznesit, i cili po akumulohet, duke propozuar masa konkrete që ky borxh të pakësohet dhe biznesi të ndihmohet. Ky është profili i një institucioni tashmë modern auditimi, i vlerësuar maksimalisht nga Bashkimi

Evropian. Nuk është cilësimi i parë tejet pozitiv që KLSH merr nga partnerët tanë më të fuqishëm. Në tetor 2012, një Raport Faktmbledhës i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian(DG-BUDGET) në Bruksel çmonte reformat e ndërmarra nga KLSH dhe orientimin e tij drejt bashkëpunimit me auditimin e brendshëm të qeverisë. SIGMA si program i OECD-se ka vlerësuar përpjekjet e institucionit për modernizimin e bazës ligjore të tij, nismën e Kryetarit të KLSH për të paraqitur në Kuvend në 26 nëntor 2012 draft-amendimet e ligjit organik mbi auditimin suprem publik. Pas këtyre cilësimeve dhe përkrahjes së madhe që KLSH merr nga partnerët e tij ndërkombëtarë, erdhi koha që edhe shoqëria jonë të besojë më shumë në këtë institucion. Kuvendi ia vlen që të tregohet më kërkues, që rekomandimet e KLSH të zbatohen nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile e opinioni publik ta mbështesin fuqimisht institucionin në nismat e tij.

¹ Botuar në gazetën “Ekonomia” datë 26 tetor 2013.